



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 6 Prot.

Tiranë, më datë 11.01.2019

VENDIM

Nr. 4, datë 11.01.2019

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.01.2019, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit: “Fabrika e pasurimit të kromit dhe dampa të sterileve”, Kraste-Theken, Bashkia Bulqize, Qarku Diber, kërkesë e shoqërisë “Koxheri” sh.p.k.
- *Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulturor: “Banesa e Bajram Xhaferit në fshatin Tërnovë”*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 144, neni 145 dhe neni 146;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Arta Dollani

KRYETAR

Mirela KUMBARO FURXHI

